



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 218, dt. 17.11.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 17.11.2015, pasi shqyrtoi termat e referencës të objekteve të diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e termave të referencës për shpalljen e konkursit ndërkombëtar për projektim peisazhistik të objektit:
Parku i Besimit në Tiranë: Kopshte meditimi e soditjeje përgjatë bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, frymëzuar nga librat e shenjtë dhe bashkejtesa fetare.
 2. Miratimin e termave të referencës për shpalljen e konkursit ndërkombëtar për projektim urban të objektit:
Projektimi i Bypass-it të qytetit të mbrojtur nga UNESCO, Gjirokastrë.
 3. Miratimin e termave të referencës për shpalljen e konkursit ndërkombëtar për ide projektimi arkitektonik të objektit:
Ridizenjimi i selisë së re të Gjykatës së Lartë të Shkollës së Magjistraturës, Tiranë.
 4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, nr. 76, Kinostudio, Tiranë, Shqipëri,
Tel. 04 4504153; 04 4504152
Email: info@imk.gov.al